REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POLIÇAN
KËSHILLI

VENDIM

Nr.50.date 28/08/2025

PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR NË BASHKINË POLIÇAN PËR VITIN 2026-2028

Në mbështejte të ligjit 139/2015 *''Për vetqeverisjen vendore''* **Ligji nr. 115/2014** *"Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"* **Ligji nr. 69/2012** "*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*" **Vendim nr. 276, datë 12.5.2021** "Për miratimin e Planit Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2021–2025" **Vendim nr. 621, datë 22.10.2021** "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e saj" **Udhëzim i përbashkët nr. 13, datë 10.07.2024**, "*Për vitin shkollor 2024-2025 në sistemin arsimor parauniversitar''*

VENDOSI :

1. Të miratoj Plain Vendor per Arsimin Parauniversitar për vitin 2026-2028 në bashkinë Ploçan sipas materialit bashkëlidhur project vendimit.

2. Për zbatimin e këtij project vendimi ngarkohet grupi i punës i ngritur me Urdhër të kryetarit me NR 279,datë 23.07.02025 si dhe stafi i bashkisë Poliçan .

3. Ky project vendim hyn në fuqi sipas ligjit 139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore"

Vendimi u miratua me 15 vota pro – vota abstenim – vota kunder.

Nr.2053/1 Prot

Date 03 /09/ 2025

Kryetari i Keshillit
Mimoza LULAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POLIÇAN

Nr. 2855/2 Prot
dt. 12.09.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT BERAT

SEKTORI JURIDIK

Nr. 695/1 Prot.

Datë 09/09/2025

Lënda: Për verifikim të ligjshmërisë së akteve.

BASHKIA POLIÇAN

Në mbështetje të Ligjit nr. 36/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" neni 16, pasi verifikova bazueshmërine ligjore të akteve, shprehem:

- Konfirmoj Vendimin nr.45 datë 28.08.2025 të Këshillit të Bashkisë Poliçan me objekt: "Për dhënien e ndihmes ekonomike , nga fondi i Kushtëzuar dhe kompesimin e Energjise Elektrike, per muajin Korrik 2025 ".
- Konfirmoj Vendimin nr.46 datë 28.08.2025 të Këshillit të Bashkisë Poliçan me objekt: "Për dhënien e ndihmes ekonomike , nga fondi I Bashkise per muajin Korrik 2025 ".
- Konfirmoj Vendimin nr.47 datë 28.08.2025 të Këshillit të Bashkisë Poliçan me objekt: "Për akordimin e nje ndihme financiare per perballimin e shpenzimeve shendetesore per bashkeshortet Z. Agron Aliaj dhe Znj. Arjana Aliaj ".
- Konfirmoj Vendimin nr.48 datë 28.08.2025 të Këshillit të Bashkisë Poliçan me objekt: " Mbi miratimin e Planit Vendor te Veprimit te Integritetit per vitin 2025-2028 per Bashkine Poliçan ".
- Konfirmoj Vendimin nr.49 datë 28.08.2025 të Këshillit të Bashkisë Poliçan me objekt: " Mbi miratimin e Planit Vendor te Veprimit te Barazise Gjinore ,ne Bashkine Poliçan, Shtator 2025-Dhjetor 2028 ".
- Konfirmoj Vendimin nr.50 datë 28.08.2025 të Këshillit të Bashkisë Poliçan me objekt: " Mbi miratimin e Planit Vendor te Veprimit te Arsimit Parauniversitar, ne Bashkine Poliçan per vitin 2026-2028"

- Konfirmoj Vendimin nr.51 datë 28.08.2025 të Këshillit të Bashkisë Polican me objekt:"Per miratimin e marrëveshjes për krijimin e personit Juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të Qeverisjes Vendore , Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA) ".
- Konfirmoj Vendimin nr.52 datë 28.08.2025 të Këshillit të Bashkisë Poliçan me objekt: " Mbi miratimin e fondit per trajnime dhe platform te njohurive te punonjesve dhe te zgjedhurve nga Akademia e Trajnimit te punonjesve te VeteQeverisjes Vendore "

PREFEKTI I QARKUT

Valbona Zylyftari

Adresa : Lagja "28 Nentori" email: prefekti.berat@mb.gov.al Tel/Fax: 032 2 34141

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POLIÇAN
SEKTORI I SHERBIMIT SOCIAL

Poliçan më 22.08.2025

RELACION

PËR

MIRATIMIN E PLANIT VENDOR PËR ARSIMIN PARAUNIVERSITAR NË BASHKISË POLIÇAN PËR VITET SHTATOR 2025- 2028

KESHILLIT BASHKIAK :

Në mbështejte të ligjit 139/2015 *''Për vetqeverisjen vendore"* **Ligji nr. 115/2014** *"Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"* **Ligji nr. 69/2012** *"Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"* **Vendim nr. 276, datë 12.5.2021** "Për miratimin e Planit Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2021–2025" **Vendim nr. 621, datë 22.10.2021** "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e saj" **Udhëzim i përbashkët nr. 13, datë 10.07.2024**, *"Për vitin shkollor 2024-2025 në sistemin arsimor parauniversitar"*

Raporti

Ky raport përfaqëson një analizë të detajuar të situatës së shërbimit të arsimit parauniversitar në territorin e Bashkisë për periudhën 2024–2025. Analiza është hartuar me qëllim të mbështetjes së proceseve të planifikimit strategjik dhe vendimmarrjes në fushën e arsimit, duke ofruar një pasqyrë të qartë mbi burimet ekzistuese, sfidat aktuale dhe mundësitë për përmirësim.

Qëllimi

Qëllimi kryesor i këtij raporti është të shërbejë si bazë për hartimin e politikave arsimore afatmesme për periudhën 2025–2028, duke u fokusuar në zhvillimin dhe përmirësimin e shërbimeve arsimore në përputhje me nevojat lokale të popullsisë, tendencat demografike, shpërndarjen gjeografike të institucioneve arsimore dhe burimet njerëzore dhe infrastrukturore në dispozicion.

Raporti synon gjithashtu të identifikojë boshllëqet në aksesin, cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve arsimore me qëllim që të krijohen kushte të barabarta arsimimi për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë në Bashki.

Procesi i Hartimit të Planit

Hartimi i Planit të Arsimit Paraunversitar është realizuar nga grup i punws i ngritur me Urdhwr tw Kryetarit si dhe në bashkëpunim me ZVA Poliçan, drejtoritë e shkollve, Zyra e Juristit dhe Shërbimmit Social në bashki ,drejtoria e kopshteve .

Ky plan u hartua pas ngritjes së Urdhërit të Kryetarit për hartimin monitorimin e tijë ,është mbledhja e të dhënave për shkollat ,kopshtet dhe cerdhet për cdo Njësi Administrative ku janë pasqyruar sipas NjA shkollat ,kopstet ,çerdhet frekuentimi i tyre nga fëmijër e moshave nga 0-18 vjeçë sipas secilës shkollë dhe Njësi Administrative.

Pergjegjes i Sektorit te Shërbimit Social

Pellumbesha Boduri

KRYETARI I BASHKISË
Adriatik ZOTKAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POLIÇAN
SEKTORI I SHERBIMIT SOCIAL

PROJEKT-VENDIM

Nr ____.date 28.08.2025

MIRATIMIN E PLANIT VENDOR PËR ARSIMIN PARAUNIVERSITAR NË BASHKISË POLIÇAN PËR VITET SHTATOR 2025- 2028

Në mbështejte të ligjit 139/2015 *''Për vetqeverisjen vendore''* **Ligji nr. 115/2014** *"Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"* **Ligji nr. 69/2012** "*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*" **Vendim nr. 276, datë 12.5.2021** "Për miratimin e Planit Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2021–2025" **Vendim nr. 621, datë 22.10.2021** "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e saj" **Udhëzim i përbashkët nr. 13, datë 10.07.2024**, "*Për vitin shkollor 2024-2025 në sistemin arsimor parauniversitar''*

VENDOSI :

1. Të miratoj Plain Vendor per Arsimin Parauniversitar Shtator 2025-Dhjetor 2028 në bashkinë Ploçan sipas materialit bashkëlidhur project vendimit.

2. Për zbatimin e këtij project vendimi ngarkohet grupi i punës i ngritur me Urdhër të Kryetarit me NR 279,datë 23.07.02025 si dhe stafi i bashkisë Poliçan .
3. Ky project vendim hyn në fuqi sipas ligjit 139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore"

Sektori I Shërbimit Social	**Juristi**	**Sekretare e Këshillit**
Pëllumbesha Boduri	**Desantila Zaimi**	**Lindita Kondi**

BASHKIA POLIÇAN

Plani i Arsimit Parauniversitar në Bashkinë Poliçan

Për Vitet 2026-2028

BASHKIA **POLIÇAN**

Tabela e përmbajtjes

1. Hyrje dhe kontksti 4

- Të dhënat demografike 5

- Kuadri Ligjor 7

2. Analiza e rrjetit arsimor parashkollor dhe perfshirjes se femijeve 8

Frekuentimi 12

3.Analiza e rrjetit arsimor shkollor dhe perfshirjes se nxenesve 12

4.Shperndarja dhe mbulimi me stafne institucionet arsimore dhe parashkollore te Bashkise Poliçan 14

5 Shërbimi i Arsimit sipas Njësive Administrative 15

Shkollat 15

Kopshtet 16

Çerdhet 17

Njësia Administrative: Vërtop 18

Njësia Administrative: Tërpan 221

6.Vizioni, qellimet strategjike, objektivat dhe permbledhja e nderhyrjeve per permiresimin e Arsimit Parauniversitar 32

9.Plani i Investmeve Kapitale 44

10. Monitorimi dhe Vlersimi 46

11.Rishikimi dhe përshtatja e planit 50

12.Raportimi dhe transparenca 51

13. Knadri Ligjor dhe nenligjor per Arsimin Parauniversitar 52

BASHKIA POLIÇAN

Parathënie

Arsimi parauniversitar mbetet themeli më ¡ rëndësishëm për ndërtimin e një shoqerie të zhvilluar, gjithëpërfshirëse dhe të barabartë. Përmes investimit në arsim ne ndërtojmë të ardhmen e fëmijëve tanë dhe përgatisim brezat e rinj për sfidat e jetës, punës dhe qytetarisë aktive. Bashkia Poliçan e ka konsideruar dhe vazhdon ta konsiderojë arsimin si një nga fushat prioritare të veprimit të saj publik.

Plani i Arsimit Parauniversitar është rezultat i një procesi gjithëperfshirës të analizës, reflektimit dhe planifikimit, i cili ndërthur të dhënat konkrete nga terreni me vizionin tonë strategjik për një sistem arsimor funksional, modem dhe të ndjeshëm ndaj nevojave të çdo fëmije në territor. Nëpërmjet këtij dokumenti, Bashkia Poliçan shpreh angazhimin e saj për të ndërtuar një sistem arsimor gjithëpërfshirës dhe të aksesueshëm në çdo pjesë të territorit - nga qëndra urbane në zonat më të thella rurale.Vizioni ynë është që të garantojmë akses të barabartë, cilësi të lartë dhe përfshirje të plotë në arsimin parauniversitar për çdo fëmijë në territorin e Bashkisë Poliçan. Përmes investimeve konkrete në infrastrukturën shkollore dhe parashkollore, në pajisje, materiale didaktike, në shërbime mbështetëse, synojmë të sigurojme kushte më të mira mësimi dhe zhvillimi për çdo fëmijë.

Qëllimi kryesor i këtij raporti është të shërbejë si bazë për hartimin e politikave arsimore afatmesme për periudhën 2026–2028, duke u fokusuar në zhvillimin dhe përmirësimin e shërbimeve arsimore në përputhje me nevojat lokale të popullsisë, tendencat demografike, shpërndarjen gjeografike të institucioneve arsimore dhe burimet njerëzore dhe infrastrukturore në dispozicion.

Raporti synon gjithashtu të identifikojë boshllëqet në aksesin, cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve arsimore me qëllim që të krijohen kushte të barabarta arsimimi për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë në Bashki.

Kryetari i Bashkisë

Adriatik ZOTKAJ

Të dhëna demografike

Sipas të dhënave më të fundit demografike, nga Regjistri i Gjendjes Civile numri total i banorëve në Bashkinë Poliçan është 15 562 banorë me një shpërndarje të përafërt gjinore prej 8053 meshkuj dhe 7 509 femra,ndërsa nga Censusi i vitit 2023 kemi një shperndarje fizike 8 762 banorë, meshkuj 4 306 dhe femra 4456 .

Struktura e popullsisë karakterizohet nga një përqindje e konsiderueshme e moshës së tret dhe një rënie e numrit të lindjeve dhe fëmijëve që frekuentojnë shkollën në moshë parashkollore dhe të rinjve, panvarsisht numrit në rënie e fëmijëve që frekuentojnë arsimin bazë dhe atë të mesëm është e rëndësishme të vlersohet zhvillimi dhe forcimit i shërbimeve arsimore në këto kategori.



Kjo përbërje demografike tregon nevojën për një planifikim të kujdesshëm të burimeve arsimore, duke marrë parasysh kërkesën për shërbime edukimi, veçanërisht në fazat e hershme të zhvillimit të fëmijëve dhe në arsimin e mesëm.

Popullsia sipas Census 2023

	Bashkia Poliçan	Poliçan	Vërtop	Tërpan
Gjithsej	8762	3492	4470	800
Femra	4456	1789	2264	403

Meshkuj	4306	1703	2206	397

Popullsia banuese sipas Cens 2023 (Grupmosha ,Gjinia sipas Njësive Administrative)

		Bashkia Poliçan	Vërtop	Tërpan
Gjinia	Grupmosha	Popullsia banuese	Popullsia banuese	Popullsia banuese
Gjithsej	Gjithsej	3492	4470	800
	0-14	342	535	47
	15-64	2127	2820	537
	65+	1023	1115	216
Meshkuj	Gjithsej	1703	2206	397
	0-14	174	276	26
	15-64	1030	5491381	263
	65+	499	549	108
Femra	Gjithsej	1789	2264	403
	0-14	168	259	21
	15-64	1097	1439	274
	65+	524	566	108

Kuadri ligjor dhe politika qe percaktuan bazen referuese per detyrat dhe pergjegjesite ne fushen e arsimit ne nivel vendor

Zbatimi i funksioneve të Bashkisë Poliçan në fushën e arsimit parauniversitar mbështetet në një kuader te gjere kushtetues, ligjor dhe politik, i cili percakton te drejtat, detyrimet dhe kompetencat e institucioneve publike per garantimin e te drejtes per arsim.

Bazen mete larte ligjore e perben **Kushtetuta e Republikes se Shqiperise,** ku ne nenin 57, pika I, sanksionohet e drejta per arsim per te gjithe qytetaret. Kjo e drejte konkretizohet me tej permes **Ligjit nr. 69/2012 "Per sistemin arsimor parauniversitar",** le ndryshuar me **Ligjin nr. 48/2018,** i cili percakton strukturen dhe funksionimin e arsimit ne te gjitha nivelet, duke perfshire arsimin parashkollor, baze, te mesem te pergjithshem dhe profesional. Ky ligj rregullon gjithashtu standardet e cilesise, perfshirjes, vleresimit dhe menaxhimit te institucioneve arsimore.

Ligji nr. 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore" i njeh bashkive kompetenca te plota per ndertimin, mirembajtjen dhe funksionimin e çerdheve dhe kopshteve publike, si dhe role mbeshtetese ne arsimin baze dhe te mesem, permes sigurimit te infrastruktures, perfshirjes sociale dhe bashkerendimit me institucionet qendrore. Keto funksione financohen dhe mbeshteten ne perputhje me **Ligjin nr. 68/2017 "Per financat e veteqeverisjes vendore"** dhe **Ligjin nr. 9936/2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetor",** te cilet percaktojne rregullat e menaxhimit financiar ne nivel vendor. Po ashtu, **Ligji nr. 9632/2006 "Per sistemin e taksave vendore",** i ndryshuar, sherben si mjet per mobilizimin e te ardhurave qe bashkia mund te perdore per te

mbeshtetur sektorin e arsimit.

Ne nivel zbatimi, funksionimi i institucioneve arsimore rregullohet nga nje sere aktesh nenligjore. Nder mete rendesishmet jane:

- **Urdhri nr. 31, date 28.01.2020,** per miratimm e rregullores se pergjithshme per funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare;
- **Udhezimi nr. 14, date 10.07.2023,** per normat e numrit te nxenesve ne klase dhe ngarkesen mesimore te mesuesve;
- **Udhezimi** i **perbashket MAS-MEKI nr. 13, date 10.07.2024,** per organizimin e vitit shkollor 2024-2025;
- **Udhezimi nr. 25, date 25.07.2018,** per ngritjen dhe funksionimin e bordeve te

institucioneve arsimore si mekanizma pjesemarrjeje, transparence dhe monitorimi.

Nje dokument me rendesi te veçante per cilesine e arsimit parashkollor eshte edhe **Urdhri nr. 199, date 07.05.2024,** qe miraton **Kornizen e vleresimit te cilesise se kopshteve.**

Ne perputhje me parimet e gjitheperfshirjes dhe mbrojtjes se te drejtave te femijeve, Bashkia Lezhe udhehiqet gjithashtu nga:

- **Ligji nr. 121/2016 "Per sherbimet e kujdesit shoqeror"**, dhe
- **Ligji nr. 18/2017 "Per te drejtat dhe mbrojtjen e femijes",** le cilet percaktojne detyrime per nderhyrje te koordinuara ne mbeshtetje te femijeve ne nevoje dhe per parandalimin e perjashtimit social.

Ne kete drejtim, udhezime specifike si:

- Udhezimi nr. 21, date 08.08.2014, per rritjen e frekuentimit te arsimit nga femijet rome;

Nje fushe me rendesi ne territorin e Bashkise Poliçan eshte edhe **ofrimi** i **sherbimit psiko-social ne shkolla,** i cili rregullohet permes:

- **Urdhrit nr. 313, date 20.10.2020, dhe**
- **Udheznesit praktik per sherbimin psiko-social shkollor, te ndertuar per stafet bashkiake dhe Zyrat Vendore Arsimore.**

Per te garantuar nje ambient dixhital te sigurt per femijet, zbatohet edhe **Udhezimi** i **perbashket MAS-MShMS nr. 658, date 23.09.2019,** qe percakton masa per mbrojtjen nga permbajtjet e demshrne ne internet.


2. Analiza e rrjetit arsimor parashkollor dhe perfshirjes se femijeve

Shpërndarja e institucioneve arsimore dhe parashkollore

Në Bashkinë Poliçan shpërndarja e institucioneve arsimore sipas njësive administrative tregon një prani të konsiderueshme të infrastrukturës shkollore dhe të arsimit parashkollor në të gjithë territorin.

Bazuar në të dhënat e paraqitura, në Bashkinë Poliçan funksionojnë 9 kopshte të shpërndara menyre te tille qe te sigurohet akses i barabarte ne edukimin parashkollor, edhe ne zonat me te thella dhe me veshtiresi gjeografike .

Shpërndarja gjeografike e kopshtit tregon një përpjekje për të garantuar akses të barabartë në edukimin parashkollor, si në qendrat urbane ashtu edhe në zonat më të thella rurale.



Ne te gjithe territorin e Bashkise Poliçan funksionojne gjithsej 9 godina qe ofrojne sherbime te arsimit parashkollor (kopsht), te cilat jane te organizuara ne dy forma:

- 6 godina ndodhen brenda ambienteve te shkollave,
- ndersa 3 godina jane me funksion te dedikuar dhe ndodhen si njesi me vete.

Kapaciteti akomodues në institucionet parashkollore

Në territorin e Bashkisë Poliçan janë të shpërndara gjithsej 9 kopshte me një kapacitet akomodues prej 104 fëmijë, të cilat mbulojnë të gjitha njësitë administrative urbane dhe rurale të bashkisë.

Njësia Admiistrative	Kapacitete akomoduese
Kopshti nr.1	18 fëmijë
Kopshti nr.2	20 fëmijë
Kopshti Mbrakull	14 fëmijë
Kopshti Vërtop	5 fëmijë
Kopshti Bregas	14 fëmijë
Kopshti Vodicë	9 fëmijë
Kopshti Peshtan	9 fëmijë
Kopshti Fushë-Peshtan	13 fëmijë
Kopshti Zhitom	2 fëmijë
Totali	104 fëmijë

Frekuentimi

Në bashkinë Poliçan, sipas të dhënave të Cens 2023, numri total i fëmijëve të moshës 3-6 vjeç është 196, prej të cilët 84 janë djem dhe 62 janë vajza.

Nga kjo popullsi, 104 fëmijë(55 djem dhe 49 femra),pra 53% ndjekin institucionet parashkollore (kopshtin).

Të dhënat mbi përfshirjen e fëmijëve të moshës 3-6 vjeç në arsimin parashkollor tregojnë se në total 77% e fëmijëve ndjekin kopshtin.

Brenda këtij grupi, përqindja e përfshirjes ndryshon midis gjinive: 52.8% e djemve dhe 47.1% e vajzave janë të përfshirë në edukimin parashkollor.

Ky ndryshim, tregon prirje që mund të ndikohen nga faktorë lokalë si infrastruktura, ndërgjegjësimi prindëror apo mundësitë ekonomike.

Këto të dhëna theksojnë rëndësinë e ndërhyrjeve të fokusuara në zgjerimin e aksesit, rritjen e ndërgjegjësimit komunitar dhe përmirësimin e infrastrukturës së arsimit parashkollor, me qëllim garantimin e të drejtës për arsim të barabartë dhe gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët e moshës 3–6 vjeç në territorin e Bashkisë Poliçan.

Përfshirja e fëmijëve nga grupet e margjinalizuara

Në institucionet e arsimit parashkollor në bashkinë Poliçan jaë të regjistruar

- 4 fëmijë të komunitetit egjiptian

Shpërndarja sipas Njësive administrative :

- Në bashkinë Poliçan janë të akomoduar 1 fëmijë
- Në Njësin Administrative Vërtop ku përbën edhe numrin më të lartë të komunitetit egjiptian janë të regjistruar 3 fëmijë.

Ne total, ne territorin e Bashkise Poliçan ushtrojne funksionin e tyre 18 edukatore, te shpemdare ne te gjitha njesite administrative. Kjo shifer perfaqeson kapacitetin aktual te stafit mesimdhenes qe mbulon arsimin parashkollor

- Poliçani ka numrin më të lartë të edukatoreve
- Dy njësit e tjera Vërtop dhe Tërpan kanë nga një edukatore për kopësht

Njësia Administrative	Ndërtesa ka sistem ngrohje funksional	Ndërtesa ka sistem elektrik funksional	Ndërtesa ka sistem hidraulik funksional
Poliçan	2	2	2
Vërtop	6	6	6
Tërpan	1	1	1

Shpërndarja dhe ofrimi i shërbmit të çerdheve

Në Bashkinë Poliçan shpërndarja e institucioneve arsimore sipas njësive administrative tregon një prani të konsiderueshme të infrastrukturës shkollore dhe të arsimit parashkollor në të gjithë territorin.

Bazuar në të dhënat e paraqitura, në Bashkinë Poliçan funksionë 1 me një kapacitet akomodues prej 13 fëmijë për zonën urbane dhe rurale të territorit të saj.

Frekuentimi

Në bashkinë Poliçan, sipas të dhënave të Cens 2023, numri total i fëmijëve të moshës 0-3 vjeç është 146, prej të cilët 68 janë djem dhe 78 janë vajza.

Nga kjo popullsi, 13 fëmijë(5 djem dhe 8 femra),pra 8.9% ndjekin institucionet parashkollore (çerdhet).

Këto të dhëna theksojnë rëndësinë e ndërhyrjeve të fokusuara në zgjerimin e aksesit, rritjen e ndërgjegjësimit komunitar dhe përmirësimin e infrastrukturës së arsimit parashkollor, me qëllim garantimin e të drejtës për arsim të barabartë dhe gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët e moshës 0-3 vjeç në territorin e Bashkisë Poliçan.

Njësia Administrativ	Kapaciteti akomodues
Poliçan	13 fëmijë

3.Analiza e rrjetit arsimor shkollor dhe perfshirjes se nxenesve

Srtutktura e shkollave dhe ndarja sipas cikleve

Shkollat në territorin e Bashkisë janë të organizuara dhe të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbulojnë sa më mirë nevojat arsimore të komunitetit. Operojne gjithsej 17 institucione arsimore te niveleve te ndryshme, duke formuar nje rrjet te gjere dhe te lannishem te arsimit parauniversitar, i cili mbulon ne menyre te plote te gjitha njesite administrative.

Rjeti shollor është i organizuar në dy nivele arsimore:


- Shkolla 9-vjeçare: 15 institucione qe perfshijne ciklin fillor dhe ate te mesem te ulet, dhe qe ofrojne nje baze te plote arsimore dhe zhvillimore
- Shkolla te mesme (te pergjithshme): 2 institucione, te cilat pergatisin te rinjte per vazhdimesi ne arsimin e larte apo per hyrje ne tregun e punes.

Shkollat 9-vjeçare, gjithsej 15 në numër, përfshijnë si ciklin fillor, ashtu edhe atë të mesëm të ulët, dhe janë projektuar për të ofruar një arsim të plotë bazë. Ato luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin akademik dhe shoqëror të nxënësve dhe përgatitjen e tyre për nivelin e ardhshëm arsimor.

Shkollat e mesme, në numër prej 2, që përfshinë gjimnazet është institucionë që synonë të formojnë të rinjtë për studime të mëtejshme universitare apo për përgatitje për tregun e punës.

Këto shkolla janë të vendosura në zona strategjike për të përfshirë një numër sa më të madh nxënësish nga zona të ndryshme të bashkisë.

Në tërësi, rrjeti arsimor i Bashkisë është konceptuar për të siguruar mundësi të barabarta arsimimi për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë, pavarësisht vendbanimit apo kushteve ekonomike.



Frekuentimi arsimi 9-vjecar (klasa e 1-9)

Në arsimin 9-vjeçar janë të regjistruar gjithsej 530 nxënës,

- prej të cilëve 275 janë djem me 51.8%
- dhe 255 janë vajza me 48.1 %.

Kjo shpërndarje pasqyron situatën aktuale të përfshirjes në këtë nivel arsimor, e cila ndryshon nga njësi në njësi dhe ndikohet nga faktorë të ndryshëm lokalë. Perqindjet tregojnë per nje vazhdimesi te pergjithshme ne pjesemarrje, por qe kerkon monitorim te rregullt per te identifikuar dhe adresuar ndonje renie te mundshme ne perfshirje, sidomos ne zonat me sfida te larta socio ekonomike.

Frekuentimi arsimi i mesem

Në arsimin e mesëm janë të regjistruar gjithsej 188 nxënës, nga të cilët 88 janë djem dhe 100 vajza, përkatësisht 46.8% djem dhe 53.1% vajza.

Ndarja gjinore në këtë nivel arsimor pasqyron situatën e raportuar për njësinë përkatëse, por këto përqindje mund të jenë të ndryshme në zona të tjera.

Shpërndarja e pjesëmarrjes në arsimin e mesëm ndikohet nga faktorë të shumtë si zgjedhjet individuale, mundësitë për të ndjekur shkolla të përgjithshme apo profesionale, si dhe faktorë socialë, ekonomikë apo kulturorë.

Kjo e bën të nevojshme që të mbështetet përfshirja e vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse në këtë nivel të rëndësishëm të arsimit.

Rrjeti arsimor i Bashkise Poliçan paraqet nje baze te qendrueshme dhe gjitheperfshirese. Pavaresisht perpjekjeve dhe infrastruktures ekzistuese, te dhenat nenvizojne nevojen per nderhyrje te synuara, si:

- Zgjerimi i aksesit ne arsimin parashkollor
- Mbeshtetje per zonat rurale dhe komunitetet vulnerabel
- Monitorim i rregullt i pjesemarrjes
- Investime ne cilesi dhe sherbime mbeshtetese per 9do nivel arsimor.

Bashkia Poliçan mund te garantoje te drejten per arsim cilesor per te gjithe femijet dhe te rinjte, pa perjashtim.

4. Shperndarja dhe mbulimi me stafne institucionet arsimore dhe parashkollore te Bashkise Poliçan

Struktura e burimeve njerezore qe mbeshtet funksionimin e sistemit te arsimit parauniversitar ne territorin e bashkise eshte e ndare sipas funksioneve kryesore: administrimi dhe drejtimi strategjik,ofrimi i sherbimit arsimor, menaxhimi ne terren, si dhe sherbimet mbeshtetese ne institucionet arsimore.

Dretoria Qëndrës Kulturore Poliçan perbehet nga 12 punonjes, te cilet jane te angazhuar ne funksione koordinuese, planifikuese dhe mbikeqyrese te sherbimeve arsimore kulturore dhe aktiviteteve rinore e sportive ne nivel vendor.

Istitucioni i Arsimit mbulohet nga një specialist i arsimit dhe kulturës , i cili luan një rol të rëndësishëm në ndjekjen ne terren te standardeve arsimore, kontrollin e cilesise dhe menaxhimin teknik te rrjetit te institucioneve me mbledhjen e të dhënave , koordinimin midis Bashkisë (Drejtorisë së Kopshteve drejtorit e shkollave) dhe ZVA

Drejtoria e Kopshteve dhe Çerdhes është e përbër nga 30 punonjës të cilët prioritar kanë ofrimi i sherbimit arsimor parashkollor edukimin e fëmijëve , monitorimin e tyre dhe angazhimet në të gjitha aktivitetet e kryera nga institucioni.

Gjithashtu, sistemi arsimor vendor mbeshtetet nga 45 punonjes sherbimi dhe mirembajtjeje - perfshire roje, sanitare dhe punonjes teknike - te cilet sigurojne funksionimin praktik te godinave dhe mjediseve shkollore.

5 Shërbimi i Arsimit sipas Njësive Administrative


Njësia Administrative: Poliçan

Shkollat

Në total, funksionojnë 3shkolla, të cilat janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbulojnë nevojat arsimore të komunitetit lokal. Nga këto, 1 shkolla është në ciklin fillor, ndërsa 1prej tyre është shkolla 9-vjeçare që ofrojnë ciklin bazë të arsimit, dhe 1 është shkolla të mesme që u japin të rinjve mundësinë për të vijuar me arsimin e lartë apo për të hyrë në tregun e punës me përgatitje profesionale.

Përmes këtij sistemi, njësia siguron një shtrirje të gjerë të shërbimeve arsimore, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit dhe krijimin e kushteve për rritje të nivelit të arsimimit dhe mirëqenies sociale.

Këto institucione janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mundësojnë akses të qëndrueshëm në arsim për fëmijët e zonës, si në vendbanimet qendrore ashtu edhe në ato periferike apo rurale.



Lista e shkollave përfshin:

EMRI	KATEGORIA
1. MUHAMET KONDI	E MESME E PËRGJITHSHME

2. 70- VJETORI	9-VJEÇARE
3. REFAT KELI	CIKËL I ULËT

Kopshtet

Në kuadër të shërbimeve arsimore dhe kujdesit ndaj fëmijëve të moshës parashkollore, në këtë njësi administrative funksionon një rrjet kopshtesh që synon të ofrojë edukim cilësor dhe mbështetje zhvillimore për fëmijët e moshës 3-6 vjeç

Aktualisht, në territorin e njësisë janë të hapura gjithsej 2 kopshte, të vendosura në zonat e afërta për tu aksesuar lehtë dhe brenda një ambjenti të sigurt ,për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit.

Këto institucione luajnë një rol të rëndësishëm si në përgatitjen e hershme për shkollë, ashtu edhe në mbështetjen sociale të familjeve.

Lista e kopshteve përfshin:

EMRI
1. KOPSHTI Nr.1
2. KOPSHTI Nr.2

Çerdhet

Në kuadër të shërbimeve arsimore dhe kujdesit ndaj fëmijëve të moshës parashkollore, në këtë njësi administrative funksionon çerdhja e qytetit e cila synon të ofrojë edukim cilësor dhe mbështetje zhvillimore për fëmijët e moshës 0-3 vjeç. Kjo çerdhe vjen si një ndihmesë familjet të cilat mund të regjistrojnë fëmijët e tyre ndonëse janë në oraret punës dhe larg banesave të tyre.

Aktualisht, në territorin e njësisë është e hapur dhe funksionale 1 çerdhe për të mbuluar nevojat e qytetitdhe zonave të afërta ,për tu aksesuar lehtë dhe brenda një ambjenti të sigurt ,për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit.

Lista e çerdhes :

EMRI
1. Cerdhja nr : 1

Njësia Administrative: Vërtop


Shkollat

Në total, funksionojnë 8 shkolla, të cilat janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbulojnë nevojat arsimore të komunitetit lokal.

Nga këto 7 shkolla janë në ciklin 9-vjeçare që ofrojnë ciklin bazë të arsimit, dhe 1 është shkollë e mesme që u japin të rinjve mundësinë për të vijuar me arsimin e lartë apo për të hyrë në tregun e punës me përgatitje profesionale.

Përmes këtij sistemi, njësia siguron një shtrirje të gjerë të shërbimeve arsimore, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit dhe krijimin e kushteve për rritje të nivelit të arsimimit dhe mirëqenies sociale.

Këto institucione janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mundësojnë akses të qëndrueshëm në arsim për fëmijët e zonës, si në vendbanimet qendrore ashtu edhe në ato periferike apo rurale.



Lista e shkollave përfshin:

EMRI	KATEGORIA

1.	Shkolla e Bashkuar Mbrakull	Shkollë e Bashkuar
2.	Kapinovë	9-Vjeçare
3.	Zgërbonjë	9-Vjeçare
4.	Fushë Peshtan	9-Vjeçare
5.	Vodicë	9-Vjeçare
6.	Tomorr i Madh	9-Vjeçare
7.	Lybeshë	9-Vjeçare
8.	Peshtan	9-Vjeçare

Kopshtet

Në kuadër të shërbimeve arsimore dhe kujdesit ndaj fëmijëve të moshës parashkollore, në këtë njësi administrative funksionon një rrjet kopshtesh që synon të ofrojë edukim cilësor dhe mbështetje zhvillimore për fëmijët e moshës 3-6 vjeç.

Aktualisht, në territorin e njësisë janë të hapura gjithsej 6 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit.

Këto institucione luajnë një rol të rëndësishëm si në përgatitjen e hershme për shkollë, ashtu edhe në mbështetjen sociale të familjeve.

Lista e kopshteve përfshin:

EMRI		
1.	KOPSHTI	MBRAKULL
2.	KOPSHTI	VËRTOP
3.	KOPSHTI	BREGAS
4.	KOPSHTI	VODICË
5.	KOPSHTI	PESHTAN

6.	KOPSHTI	FUSHË-PESHTAN


Njësia Administrative: Tërpan

Shkollat

Në total, funksionojnë 6 shkolla, të cilat janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbulojnë nevojat arsimore të komunitetit lokal.

Të 6 shkollat janë shkolla 9-vjeçare që ofrojnë ciklin bazë të arsimit, njësia siguron një shtrirje të gjerë të shërbimeve arsimore, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit dhe krijimin e kushteve për rritje të nivelit të arsimimit dhe mirëqenies sociale.

Këto institucione janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mundësojnë akses të qëndrueshëm në arsim për fëmijët e zonës, si në vendbanimet qendrore ashtu edhe në ato periferike apo rurale.



Lista e shkollave përfshin:

EMRI	KATEGORIA
1.TËRPAN	9-VJEÇARE
2.ZHITOM	9-VJEÇARE
3.TEMAN	9-VJEÇARE
4.TOZHAR	9-VJEÇARE

BASHKIA POLIÇAN

6.Vizioni,qellimetstrategjike,objektivatdhepermbledhjaenderhyrjeveper permiresimin e Arsimit Parauniversitar

Vizioni

"Te mbeshtesim nje sistem arsimor parauniversitar te hapur, gjitheperfshires dhe te qendrueshem, qe garanton kushte dinjitoze mesimi dhe zhvillimi per do femije, ne do njesi administrative te territorit te Bashkise Polican duke investuar ne infrastrukture, sherbime mbeshtetese cilesore dhe njëv grup arsimtaresh e drejtuesish te kualifikuar, si themel per nje te ardhme me te drejte, te barabarte dhe te begate".

Elementet ky qe mbeshtesin kete vision:

- **Akses i barabarte ne arsim,** permes shpemdarjes se balancuar te shkollave dhe kopshteve ne zona urbane dherurale.
- **Investime te synuara** per rikonstruksionin dhe pajisjen e institucioneve arsimore me mjete dhe teknologji modeme, si dhe per permiresimin e kushteve themelore: ngrohje, uje, energji, siguri, higjiene dheushqim.
- **Perfshirje sociale dhe gjitheperfshirje,** me perkujdesje te veçante per femijet me aftesi ndryshe, femijet nga familje me ndihme ekonomike, dhe ata nga komunitetet rom dhe egjiptian.
- **Permiresim i cilesise se edukimit,** permes zhvillimit profesional te mesuesve dhe edukatoreve, si dhe shtimit te sherbimeve psiko-sociale dhendihmese.
- **Lidhje e shkolles me komunitetin,** permes aktivizimit te bordeve te kopshtit dhe shkolles, dhe bashkepunimit me institucionet kulturore, sportive dhe shoqerinecivile.
- **Digjitalizim dhe menaxhim me i mire ibazuar ne te dhena dhe analize,** per te garantuar transparence, monitorim te performances dhe reagim te shpejte ndaj nevojave neterren.

Permbledhje e Qellimeve, Objektivave dhe Aktiviteteve

Qellimi 1: Permiresimi i infrastruktures arsimore dhe garantimi i kushteve themelore ne institucionet parauniversitare ne te gjithe territorin e Bashkise Polican.

Objektivat:

- 1.1: Sigurimi i funksionimit te panderprere te shkollave dhe kopshteve ne 9do nJesl administrative te Bashkise Polican permes angazhimit te stafit te kualifikuar (arsimor dhe sherbimeve mbeshtetese), si dhe ofrimit te sherbimeve haze si uji i pijshem, energjia elektrike, sistemi i ngrohjes, higjiena, ushqimi, pajisjet etj.

- 1.2: Modemizimi i kapaciteteve menaxheriale dhe monitoruese te sistemit arsimor vendor nepermjet permiresimit te te dhenave, digjitalizimit te proceseve administrative dhe forcimit te bashkepunimit nderinstitucional.

Qellimi 2: Rritja e cilesise se edukimit dhe garantimi i perfshirjes se barabarte te femijeve ne sistemin parauniversitar.

Objektivat:

- 2.1: Zhvillimi i vazhdueshem profesional i stafit edukativ te arsimit parashkollor ne perputhje me kurrikulat bashkekohore dhe metodologjite e reja pedagogjike.
- 2.2: Forcimi i sherbimeve mbeshtetese per femijet me aftesi ndryshe, perfshire psikologet shkollore, punonjes sociale, mesues ndihmes-stafte specializuar.
- 2.3: Konsolidimi i bashkepunimit midis shkolles-kopshtit, familjes dhe komunitetit permes keshillave te prinderve dhe bordeve, me qellim rritjen e perfshirjes dhe mbeshtetjes per procesin edukativ.

Qellimi 3: Nxitja e zhvillimit te gjithanshem te femijeve dhe nderveprimi i institucioneve arsimore me jeten kulturore, sociale dhe komunitare te Bashkise Polican.

Objektivat:

- 3.1: Promovimi i pJesemarrjes se femijeve dhe te rinjve ne aktivitete jashtemesimore (kulturore, artistike, sportive, sociale) qe mbeshtesin zhvillimin e tyre emocional, fizik dhe shoqeror.
- 3.2: Krijimi i partneriteteve te qendrueshme me institucione kulturore, qendra komunitare, organizata rinore dhe sportive ne Bashkine Lezhe per te pasuruar oferten edukative dhe per te rritur ndarveprimin mes shkollave dhe komunitetit local.

Permbledhje e investimeve kapitale (2026-2028)

Plani i investimeve kapitale per arsimin parauniversitar ne Bashkine Poliçan per periudhen afatmesme 2025-2028 synon permiresimin e kushteve infrastrukturore dhe pajisjeve baze te institucioneve arsimore, me fokus te veçante tek kopshtet , çerdhen dhe shkollat 9-vjeçare. Vlera totale e investimeve te planifikuara arrin ne 9826 mije !eke, me burim financimi nga buxheti i Bashkise Poliçan.
Ky plan reflekton nje qasje te kombinuar nderhyrjesh: investime kapitale ne rikonstruksion ne vitin 2025, dhe blerje pajise e orendi 2026-2028. Permes ketij plani, Bashkia synon te rrise sigurine, funksionalitetin dhe cilesine e sherbimeve ne institucionet e arsimit parauniversitar.

1. Investime per permiresimin e infrastruktures dhe kushteve mjedisore

planifikuara arrin ne 25 512 410 mije leke për vitin 2025, me burim financimi nga buxheti i Bashkise Poliçan.
Ky plan reflekton nje qasje te kombinuar nderhyrjesh: investime kapitale ne rikonstruksion dhe pajisje ne vitin 2025, dhe mirembajtje te qendrueshme ne vitet pasuese 2026-2028. Permes ketij plani, Bashkia synon te rrise sigurine, funksionalitetin dhe cilesine e sherbimeve ne institucionet e arsimit parauniversitar.

1. Investime per permiresimin e infrastruktures dhe kushteve mjedisore

- Mirëmbajtje e godinave të arsimit parashkollor, 9-vjecare,e te mesëm - me vlere 3 600 000 mije !eke, parashikohet rehabilitimi i ambienteve te arsimit parashkollor, per te siguruar standarde te barabarta edukimi ne te gjithe territorin e bashkise.
- .

2. Investime ne pajisje dhe funksionalitet teknik

- Blerje te materialeve për mobilim ,sportive,kancelari dhe mjete didaktike per kopshtet ,cerdhet- nje fond total prej 6 000 000 mije Iekesh ne kater vite.
- Blerje soba dru zjari,nafte per ngrohje ,blerje gazi, mirembajtje e kaldajeve - me total 23 040 000 mije !eke , si mbeshtetje per mireqenien dhe higjienen e femijeve ne kater vite.
- Blerje elektroshtepiakesh dhe enesh kuzhine ,ushqime per cerdhen - per permiresimin e sherbimeve te ushqyerjes ne kopshtet publike, me aje total investimi prej 5 760 000 mije lekesh ne kater vite.
- Materiale hidarulike, elektrike - me nje fond total prej 5 960 000 mije lekesh ne kater vite, qe mbeshtet garantimin e aksesit ne uje dhe energji elktrike ne institucionet arsimore te territorit.
